



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2020

V E N D I M

Nr. 125, datë 05/10/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesa nr. 159, datë 16.12.2019, e znj. S.K., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e operatorit të transportit urban “Remi Trans” sh.p.k., që operon në linjën ndërqytetase Tiranë – Vorë – Tiranë dhe përkatësisht ndaj autobusit me targë AA 397 TM dhe faturinos së këtij autobusi.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesja S.K. është banore e qytetit të Shkodrës. Referuar vërtetimit nr. 1313, datë 16.12.2019, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës, Dega Shkodër, si dhe kopjes së Dëshmisë së Invaliditetit, ankuesja gëzon statusin e Invalidit të Plotë të Punës. Pretendimi i saj për diskriminim, për shkak të aftësisë së kufizuar, kundër operatorit të transportit urban “Remi Trans” sh.p.k., që operon në linjën ndërqytetase Tiranë – Vorë – Tiranë dhe përkatësisht ndaj autobusit me targë AA 397 TM dhe faturinos së këtij autobusi, lidhet me faktin se, në datën 12.12.2019, ankuesja ka qenë duke udhëtuar në linjën dhe autobusin e sipërpërmendur.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Gjatë udhëtimit, ndërkohë që ajo i ka paraqitur faturinos së autobusit, Dëshminë e saj të Invaliditetit, me qëllim përfitimin e zbritjes prej 50% të biletës së udhëtimit, ky i fundit, jo vetëm që nuk ka pranuar të kryejë reduktimin e çmimit të biletës, por nuk ia ka kthyer më znj. S.K., dokumentin e sipërpërmendur. Aktualisht, ankuesja disponon vetëm kopje të kësaj dëshmie, pasi i mungon origjinali.

Në këto kushte, znj. S.K. kërkon ndërhyrjen e Komisionerit, për kthimin e dokumentit të marrë dhe ndalimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

A. Fillimisht, Komisioneri pati korrespondencë zyrtare me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të marrë informacion mbi operatorin e shërbimit urban, i cili nuk ishte i identifikuar nga ankuesja. Nëpërmjet shkresës nr. 1968, datë 26,12,2019, dërguar këtij institucioni, Komisioneri kërkoi të dispononte të dhëna të sakta lidhur me operatorin urban ndërqytetas, i cili është subjekt i ankesës së Znj. S.K..

1. Nëpërmjet shkresës nr. 27656/1, datë 30.12.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor e informoi Komisionerin mbi operatorin urban të linjës ndërqytetase Tiranë-Vorë-Tiranë, Remi Trans sh.p.k. Në shkresën e këtij institucioni citohet “*....Në lidhje me informimin për linjën e transportit Tiranë – Vorë, organi që ka si objekt veprimtarie liçensimin dhe certifikimin është Bashkia, në referim të nenit 1, të Udhëzimit Nr. 3917, datë 18.07.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetase””, i ndryshuar, përcaktohet se linjat ushqyese me distancë deri në 16 km dhe të përfshira në aneksin 2, të cilat lidhin bashkë të njëjtin qark, do të trajtohen nga bashkitë përkatëse. Gjithashtu edhe në Udhëzimin Nr. 437, datë 09.05.2018, e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, linja ndërqytetase Tiranë – Vorë - Tiranë përfshihet në aneksin 2 të rrjetit të linjave ndërqytetase, të cilat liçensohen dhe certifikohen nga Bashkia përkatëse.”*

B. Në vijim, pas analizimit të ankesës nr. 159, datë 16.12.2019, së znj. S.K., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr.

10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

C. Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 19, datë 07.01.2020, operatorit të transportit urban “Remi Trans” sh.p.k. dhe për dijeni Bashkisë Tiranë, ku kërkohej informacioni, si më poshtë vijon:

- ✓ Kryeja e verifikimeve përkatëse, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja S.K., si dhe informacionin mbi përfundimet përkatëse të verifikimeve.
- ✓ Kopje e Kontratës së Shërbimit, të lidhur me Bashkinë e Tiranës;
- ✓ Informacion mbi faktin, nëse zbatohen parashikimet ligjore mbi lehtësitë e ofruara për transportin urban ndërqytetas, për invalidët e punës.
- ✓ Identifikimi i faturinos së autobusit me targë AA 397 TM, si dhe dorëzimi i Dëshmisë së Invaliditetit tek ankuesja S.K.;

1. Operatori urban ndërqytetas “Remi Trans” sh.p.k. nuk i ktheu përgjigje shkresës së Komisionerit.

2. Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur të KMD-së, Drejtoria Juridike e Bashkisë Tiranë përcolli për dijeni të Komisionerit, shkresën nr. 509/1, datë 20.01.2020, nëpërmjet së cilës e delegon shkresën e KMD-së, për kompetencë tek Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, pranë të njëjtit institucion.

3. Nëpërmjet shkresës nr. 509/2, datë 23.01.2020, Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, të Bashkisë Tiranë, i përcjell për kompetencë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, kërkesën për informacion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në shkresën e sipërpërmendur citohet: *“Duke qenë se linja bën pjesë në rrjetin e linjave ndërqytetase ushqyese e liçencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, po ju përcjellim bashkëlidhur për kompetencë shkresën origjinale me nr. Prot. 509, datë 08.01.2020”*.

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

4. Në vijim të shkresës së sipërpërmendur, Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, të Bashkisë Tiranë e njofton Komisionerin nëpërmjet shkresës nr.509/3, datë 28.01.2020, se linja “Tiranë-Vorë-Tiranë” bën pjesë në rrjetin e linjave ndërqytetase të miratuar me Udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, *“Për miratimin e rrjetit të liçencave ndërqytetase”* dhe është e liçencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
5. Në vijim të shkresave të sipërpërmendura, KMD iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 214, datë 03.02.2020, shkresë, e cila iu drejtua për dijeni Bashkisë Tiranë dhe ankueses S.K.. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) iu kërkua të dërgohej brenda datës 10.02.2020, informacioni i mëposhtëm:
 - ✓ Kopje e Kontratës së Shërbimit, të lidhur me operatorin urban ndërqytetas “Remi Trans” sh.p.k.;
 - ✓ Informacion mbi faktin, nëse zbatohen parashikimet ligjore mbi lehtësitë e ofruara për transportin urban ndërqytetas, për invalidët e punës;
 - ✓ Ndërhyrja e MIE mbi subjektin Remi Trans sh.p.k., për të kryer verifikimet përkatëse mbi këtë çështje, si dhe për dorëzimin e Dëshmisë së Invaliditetit tek ankuesja;
6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk i dërgoi përgjigje shkresës së Komisionerit.
7. Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërish me shkresën nr.19/1, datë 24.02.2020, operatorit urban ndërqytetas Remi Trans sh.p.k., ku i bën kujtesë për t’i kthyer përgjigje, brenda datës 02.03.2020, shkresës nr. 19, datë 07.01.2020, së KMD-së. Komisioneri e bën me dije Remi Trans sh.p.k., se mosdhënia e këtij informacioni përbën shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* dhe në bazë të pikës 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, Remi Trans sh.p.k. do të gjobitet me vendim të Komisionerit.
8. Zarfi me shkresën nr.19/1, datë 24.02.2020, e KMD-së drejtuar Remi Trans sh.p.k. u kthye mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin *“marrësi nuk është në adresë në kohën e dorëzimit”*.
9. Në këto kushte, me Vendimin nr. 26, datë 03.03.2020, e Komisionerit, Remi Trans sh.p.k. u gjobit për mosdhënie informacioni.

10. Në vijim, në datën 16.04.2020, Remi Trans sh.p.k. ka dërguar e-mail në adresë të KMD-së ku kërkon shfuqizimin e vendimit me gjobë, pasi z. XH. D., shofer i autobusit ishte liruar nga detyra.

- KMD i dërgoi përgjigje këtij operatori se duhet të dërgonte përgjigje zyrtare në lidhje me kërkesat dhe aktet e kërkuara nga KMD, si dhe informacioni i kërkuar të dërgohej brenda datës 20.04.2020.
- Në vijim, shoqëria Remi Trans nuk dërgoi më asnjë e-mail dhe nuk pati korrespondencë zyrtare me KMD-në.

D. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet **në datën 29.06.2020, ora 12:00**, pranë Zyrës së KMD-së. Në seancë dëgjimore u ftuan për pjesëmarrje edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë.

Në seancë mori pjesë znj. L.D., përfaqësuese ligjore e znj. S.K. dhe znj. R.B. përfaqësuese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Ndërkohë që, u konstatua se Bashkia Tiranë dhe Remi Trans sh.p.k. nuk kishin dërguar përfaqësues në këtë seancë dëgjimore.

Në këtë seancë dëgjimore, përfaqësuesja ligjore e znj. S.K. dhe sqarime më të qarta mbi ankesën e saj, të cilat nuk ishin dhënë saktësisht në ankesën e depozituar pranë KMD-së.

Përfaqësuesja ligjore e ankueses sqaroi se ankuesja S.K., e datëlindjes 29.08.1960, me numër personal G05829056P, lindur dhe banuese në Shkodër është invalide e plotë. Ajo ka zotëruar një dëshmi invaliditeti me numër 1551, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë, në bazë të dosjes së invalidit nr. 123201/2. Kjo dëshmi invaliditeti ka pasur një afat përdorimi një vjeçar, përkatësisht për periudhën **03.11.2018 - 03.11.2019**. Ajo është pajisur për herë të parë në vitin 2018 me dëshminë zyrtare të identifikimit të invaliditetit nga Shoqata e Invalidëve të Punës.

Më datë 12.12.2019 znj. S.K. ka udhëtuar nga Shkodra për në Tiranë për të takuar bashkëshortin e saj. Pasi ka ndaluar në terminalin e autobuzave të veriut, përballë pallatit të sportit “Asllan Rusi”, ajo ka lëvizur në drejtim të I EVP 313 me autobuzin e linjës së Tiranës së Re ku nuk ka pasur asnjë problem në përdorimin e dëshmisë së invaliditetit. Gjithashtu, pasi ka realizuar takimin me bashkëshortin e saj, ajo është nisur në drejtim të Vorës, për të vizituar motrën e saj të sëmurë. Gjatë udhëtimit nga Tirana-Vorë, ajo ka paraqitur dëshminë e invaliditetit, kur i është kërkuar nga faturino dhe nuk ka pasur përsëri asnjë problem. Pasi ka realizuar takimin me motrën e saj, në mesditë, ka marrë linjën e transportit urban publik në Tiranë, përkatësisht në linjën Tiranë-Vorë, për t’u kthyer tek terminali i autobuzave të Shkodrës.

Në momentin e prerjes së biletës, ankuesja i ka dorëzuar dëshminë origjinale të invaliditetit, faturinos së autobusit. Pas dorëzimit, faturino ka konstatuar se afati i vlefshmërisë së dëshmisë së invaliditetit ka përfunduar para disa ditësh. Ai ia ka marrë dëshminë e skaduar dhe nuk ia ka kthyer më mbrapsht. Ankuesja nuk ka qenë e vetëdijshme për skadencën e këtij dokumenti. Ajo është vënë në dijeni për përfundimin e vlefshmërisë së dëshmisë në momentin që e ka paraqitur para faturinos. Pasi është njohur lidhur me faktin e skadencës së dëshmisë së invaliditetit, ankuesja i ka kërkuar faturinos që t'ia kthejë mbrapsht dokumentin dhe të paguajë biletën e udhëtimit. Faturino nuk ka pranuar të kthejë dokumentin pa asnjë shpjegim. Znj. S.K. është tensionuar nga kjo ngjarje dhe ka filluar të qajë, pasi faturino refuzoi kërkesën e saj për t'i kthyer dëshminë e invaliditetit. Gjithashtu, një udhëtar që ishte i pranishëm në autobuz në atë moment, duke parë gjendjen emocionale të Znj. S.K., të shokuar nga kjo ngjarje, ka ndërhyrë dhe i ka kërkuar faturinos t'ia kthejë zonjës dokumentin. Pavarësisht kërkesave të udhëtarit dhe zonjës, faturinoja e ka sekuestruar dëshminë e invaliditetit. Para se të zbriste nga autobuzi, pranë stacionit të pallatit të sportit "Asllan Rusi", znj. S.K. ka tentuar edhe njëherë duke kërkuar nga faturino t'i kthente dokumentin që i kishte marrë, pasi i duhej për të tërhequr pensionin, por ai nuk ka pranuar ta bëjë një gjë të tillë. Ajo ka mundur të bëjë vetëm një foto të faturinos nëpërmjet telefonit të saj dhe një foto targës së autobusit.

Pas kësaj ngjarje, znj. Safete është paraqitur pranë degës së shoqatës së invalidëve në Shkodër dhe ka kërkuar që të pajiset me një dëshmi të re invaliditeti. Punonjësit e kësaj zyre e kanë refuzuar lëshimin e një dokumenti të ri dhe e kanë sqaruar se për t'u pajisur me një dëshmi të re, duhet të dorëzohet dëshmia e vjetër. Pas shumë këmbënguljesh dhe pasi iu ka treguar historinë e mbajtjes së dokumentit nga faturino në Tiranë, e faktin që ajo është e vetme dhe jeton vetëm në saj të pensionit të invaliditetit, punonjësit kanë pranuar të lëshojnë një dokument të ri identifikues. Aktualisht, zonja zotëron dëshminë e invaliditetit me nr. 1313, datë 16.12.2019 të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Shqipërisë, Dega Shkodër, me periudhë vlefshmërie 03.11.2019-03.11.2020. Punonjësit e shoqatës, pavarësisht lëshimit të dokumentit të ri, kanë këmbëngulur që ankuesja detyrimisht të bëjë përpjekje për ta marrë dokumentin e marrë nga faturino dhe ta depozitojë pranë zyrës së tyre.

Përfaqësuesja ligjore e ankueses theksoi faktin se sjellja e faturinos është në kundërshtim me çdo rregullore të transportit urban, pasi nuk është detyrë dhe kompetencë e tij të sekuestrojë dokumentin e dëshmisë së invaliditetit. Ai është një dokument që mund të lëshohet dhe tërhiqet vetëm nga Shoqata e Invalidëve të Punës. Detyra e faturinos është vetëm të kontrollojë vlefshmërinë dhe rregullsinë e dokumentit dhe nëse ky person nuk përmbush kriteret për të udhëtuar falas, ose për të përfituar zbritje në çmimin e biletës, udhëtari është i detyruar të

paguajë biletën e udhëtimit. Faturino i autobusit mund të refuzojë të pranojë përdorimin e dëshmisë së invaliditetit, por jo t'i sukestrojë dokumentin e identifikimit personit invalid, që e posedon.

Kjo ngjarje ka sjellë pasoja shumë të rënda për gjendjen psiko-emocionale të ankuseses, të cilat janë të një niveli shumë të lartë edhe për shkak të llojit të sëmundjes që ajo vuan. Në jetën e saj zonja ka kaluar trauma të cilat e kanë kthyer në invalide pune të plotë, vlerësuar nga mjekët specialistë si çrregullim madhor depresiv. Përfaqësuesja ligjore e ankuseses vë në dukje faktin se faturinoja mund ta kishte sqaruar znj. S.K. mbi përdorimin e dëshmisë së invaliditetit, faktin që ajo ka një vlefshmëri e cila nuk lejon përfitimin e benefiteve të caktuara nga ligji jashtë afatit të vlefshmërisë dhe t'ia kthente dokumentin zonjës, ndërkohë që ajo bën pagesën e rregullt të çmimit të biletës së udhëtimit. Ndërkohë që, faturinoja ka mbajtur, pa asnjë lloj të drejtë, dëshminë e invaliditetit të zonjës, duke e demonstruar këtë gjë publikisht para udhëtarëve të tjerë dhe duke e bërë të ndihet keq në një ambient publik, për shkak të aftësisë së saj të kufizuar, duke cenuar integritetin e saj personal.

Një gjë e tillë ka shkaktuar tension, frikë dhe pasiguri tek znj. S.K. dhe trauma psikologjike për shkak të trajtimit jokorrekt nga ana e faturinos. Ajo është trajtuar prej tij në një mënyrë të tillë që ka shkelur dinjitetin e saj dhe është diskriminuar për aftësinë e saj të kufizuar. Situata të tilla, jo vetëm që çënojnë ndjenjat njerëzore të ankuseses, dinjitetin e saj, por edhe rëndojnë gjendjen psikologjike dhe çrregullimin depresiv që ajo ka. Në bazë të nenit 17 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar parashikohet shprehimisht mbrojtja e integritetit fizik dhe mendor të personit me aftësi të kufizuar.

Gjithashtu, ankuesja është vënë përballë një situatë shumë të vështirë, ku i është dashur të pajiset me një dëshmi tjetër invaliditeti dhe nuk ka qenë e lehtë të sigurohet për shkak të mungesës së dokumentit të vjetër që kishte skaduar. Pa këtë dokument ajo nuk mund të tërhiqte pensionin. Ankuesja vazhdon ta vuajë shpirtërisht këtë ngjarje, ajo shprehet se nuk ka pasur asnjë qëllim të mashtrorë faturinon dhe nuk e ka ditur për vlefshmërinë një vjeçare të dokumentit. Në vitin 2018, ajo është pajisur për herë të parë me dëshminë e invaliditetit dhe në momentin që i është sekuestruar nga faturino nuk ka pasur dijeni të mëparshme për mbarimin e vlefshmërisë së saj para disa ditësh.

Përfaqësueja ligjore theksoi faktin se subjekti ndaj te cilit është ngritur ankimi, faturino dhe operatori transportit urban “Remi Trans” shpk duhet të provojnë se ka pasur një shkak objektiv që e ka shtyrë për të mbajtur dëshminë e invaliditetit të ankuseses. Mbajtja e dëshmisë ka shkaktuar efekte përjashtuese të ankuseses, e cila nuk mund të merrte pensionin dhe as të pajisej

me një dëshmi të re invaliditeti. Pra, ajo është penguar të ushtrrojë të drejta të tjera të njohura me ligj, si rezultat i veprimit të kryer nga faturino. Në bindjen e tyre, nuk ekziston asnjë shkak objektiv për sekuestrimin e dëshmisë dhe ky veprim është diskriminues për ankuesen për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e faturinos.

Në vijim, mori fjalën përfaqësuesja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila sqaroi se nëpërmjet Udhëzimit nr. 437, datë 09.05.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ky institucion i ka kaluar Bashkisë Tiranë kompetencat mbi licencat e operatorëve urbanë. Pas marrjes së ankesës, Ministria ia ka kaluar atë Bashkisë Tiranë dhe Task Forcës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 914, datë 06.07.2020, KMD iu drejtua Task Forcës për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Motorike e Rimorkiove të Tyre dhe për dijeni Bashkisë Tiranë, Remi Trans sh.p.k. dhe ankueses S.K.. Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri kërkon nga ana e Task Forcës, që brenda kompetencave të saj, të kryejë verifikimet përkatëse mbi operatorin urban ndërqytetas Remi Trans sh.p.k. lidhur me çështjen objekt ankese, si dhe të dërgoje pranë KMD-së informacionin përfundimtar.
2. Me shkresën nr. 1136/1, datë 30.07.2020, Task Forca për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Motorike e Rimorkiove të Tyre i kthen përgjigje shkresës së mësipërme të KMD-së. Sipas shkresës në fjalë rezulton se punonjësit e autorizuar të Task Forcës kanë kryer kontrole në terren për verifikimin e dokumnetacionit të shoqërisë Remi Trans sh.p.k. që operon në linjën ndërqytetase Tiranë-Vorë-Tiranë. Nga kontrolli i ushtruar ka rezultuar se të katërt mjetet e kësaj firme ishin të pajisura me dokumentacion të rregullt. Në vijim, është realizuar një takim me administratorin e kësaj shoqërie, i cili ka sqaruar se për shkak të rinisjes së punës në muajin qershor 2020, pas periudhës së pushimit që lidhet me Pandeminë e COVID-19 mund të kenë ndodhur raste të veçanta, kur kategoria e individëve me aftësi të kufizuar ka paguar të gjithë tarifën e biletës, pasi ata nuk kanë qenë të pajisur me dokumentacionin e azhornuar nga institucionet përkatëse.

A. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses.

Znj. S.K. pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e operatorit të transportit urban “Remi Trans” sh.p.k., që operon në linjën ndërqytetase Tiranë – Vorë – Tiranë dhe përkatësisht ndaj autobusit me targë AA 397 TM dhe faturinos së këtij autobusi.

Ankuesja është invalide e plotë e punës dhe dispononte Dëshminë nr. 1551, datë 03.11.2018, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë. Vlefshmëria e dëshmisë së sipërcituar ka qenë 1 (një) vit, dmth nga data **03.11.2018 – 03.11.2019**.

Në datën 12.12.2019, ankuesja ka udhëtuar me njërin nga autobusët e linjës ndërqytetase Tiranë – Vorë – Tiranë. Në kushtet kur, ajo gëzonte statusin e invalidit të punës, në bazë të nenit 11, të Ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “*Për Statusin e Invalidëve Të Punës*”, (të ndryshuar)³, duhet të përfitonte udhëtim me me 50 për qind të vlerës së biletës, por ajo pretendon se nuk ka qenë e vetëdijshme për skadencën e këtij dokumenti. Në momentin e paraqitjes së Dëshmisë tek faturino i autobusit, ky i fundit ka konstatuar se vlefshmëria e Dëshmisë së Invaliditetit të ankueses kishte përfunduar prej më shumë se 1 muaji. Pasi është njohur lidhur me faktin e skadencës së dëshmisë së invaliditetit, ankuesja i ka kërkuar faturinos që t’ia kthejë mbrapsht dokumentin dhe të paguajë biletën e udhëtimit. Faturino nuk ka pranuar të kthejë dokumentin pa asnjë shpjegim.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “*Për Statusin e Invalidëve Të Punës*”, (të ndryshuar), statusin e invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme, që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë*”, i ndryshuar, ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “*Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore*”, i ndryshuar dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.”

Mbështetur në nenin 4 të ligjit të sipërcituar invalidët pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi, e cila lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës, në bazë të KMAC. Duke paraqitur këtë dëshmi zyrtare identifikimi, invalidët e punës përfitojnë një sërë lehtësirash që ky ligj ofron për ta në fusha të ndryshme, ku përfshihet edhe transporti urban. Në këtë kontekst, ky dokument është

³ Në bazë të nenit 11, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “*Për Statusin e Invalidëve Të Punës*”, (të ndryshuar) përcaktohet: “*Udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqytetas bëhet me 50 për qind të vlerës së biletës.*”

tepër i rëndësishëm për ta. Në përfundim të vlefshmërisë së këtij dokumenti, ata pajisen me një dokument të ri identifikimi, pasi të kenë dorëzuar dokumentin paraardhës.

Neni 16, i ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar) parashikon: *“Transporti ndërqytetës është shërbimi, që plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet: a) bashkive qendër të rretheve të ndryshme brenda një qarku dhe bashkisë jo qendër rrethi, me bashki qendër të një rrethi tjetër brenda një qarku; b) bashkive qendër të rretheve për qarqe të ndryshme; c) bashkisë jo qendër rrethi me qendër rrethi të qarqeve të ndryshme; ç) bashkive qendër të rretheve me stacionet hekurudhore, skajore, për vazhdimin e udhëtimit, duke ndryshuar llojin e transportit, aeroportin dhe bankinen liqenore.”*

Neni 11, i ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 *“Për Statusin e Invalidëve Të Punës”*, (të ndryshuar) parashikon shprehimisht: *“Udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqytetas bëhet me 50 për qind të vlerës së biletës.”*

Zbatueshmëria e parashikimit ligjor të sipërpërmendur lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me disponimin e një Dëshmie Invaliditeti brenda afatit të saj të vlefshmërisë. Fakti lidhur me përfundimin e vlefshmërisë së Dëshmisë së Invaliditetit, të znj. S.K., në momentin që ajo ka udhëtuar në operatorin urban “Remi Trans” sh.p.k., u bë i ditur nga përfaqësueja ligjore e znj. S.K., gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioneri. Në kushtet kur, kjo dëshmi nuk ka qenë e vlefshme pra ishte e skaduar, ankuesja duhet të paguante vlerën e plotë të biletës së udhëtimit. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se pretendimi i saj lidhur me moszbatimin e nenit 11, të ligjit të sipërpërmendur nga ky operator bie poshtë.

Në nenin 2 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 *“Për Statusin e Invalidëve Të Punës”*, (të ndryshuar) parashikohet shprehimisht: *“Shoqëria dhe shteti marrin në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, t’u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t’u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese.”*

Njëkohësisht, në nenin 3 të këtij ligji parashikohet gjithashtu se: *“Shteti mbron invalidët nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes.”*

Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar sjellje jo të denjë të faturinos së autobusit me targë AA 397 TM, të operatorit urban “Remi Trans”, i cili duhet ta kishte vënë në dijeni ankuesen për kalimin e afatit të vlefshmërisë së Dëshmisë së Invaliditetit, pasi e ka konstatuar një fakt të tillë, si dhe t’i kërkonte që të kryente pagesën e plotë të shërbimit urban ndërqytetas, por në asnjë mënyrë nuk ka patur të drejtë t’ia marrë apo sekuestrojë dëshminë e skaduar. Komisioneri gjykon se veprimi i tij është i pajustificueshëm, aq më tepër kur ankuesja i ka kërkuar disa herë me rradhë t’i kthente dëshminë e saj të invaliditetit. Për sa më sipër, faturino i autobusit ka abuzuar me detyrën e tij, duke kryer një veprim të tillë dhe përgjegjësia e drejtpërdrejtë për një ndodhi të tillë është e operatorit urban, që është edhe punëdhënësi i tij.

Komisioneri gjykon se sjellja e punonjësit të këtij operatori urban konsiston në mungesë të theksuar respekti ndaj znj. S.K., si dhe qendrimi i tij është gjithashtu tepër fytes e denigruës ndaj personave me aftësi të kufizuara. Në interpretim të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri gjykon se ankuesja S.K. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e operatorit urban “Remi Trans”.

A. Shkaku i mbrojtur.

Znj. S.K. pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e operatorit të transportit urban “Remi Trans” sh.p.k., që operon në linjën ndërqytetase Tiranë – Vorë – Tiranë dhe përkatësisht ndaj autobusit me targë AA 397 TM dhe faturinos së këtij autobusi.

“Aftësia e kufizuar” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri gjykon se “aftësia e kufizuar” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe në bazë të dokumentacionit të depozituar nga

ankuesja, përkatësisht Dëshmisë nr. 1313, datë 03.11.2019, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë⁴, rezulton se ajo është individ me aftësi të kufizuara.

B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – aftësinë e kufizuar.

Gjatë analizimit të fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se ankuesja është ekspozuar para nja trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga operatori urban Remi Trans sh.p.k.

Legjislacioni ndërkombëtar dhe ai shqiptar ofron mbrojtje nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe sidomos përmban parashikime të posaçme lidhur me nxitjen e respektit dhe mbrojtjen e dinjitetit të tyre. Në këtë kuadër, Konventa “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” është një ndër instrumentet ligjorë më të rëndësishëm, qëllimi i së cilës është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre⁵.

Sipas nenit 2 të kësaj Konvente “*diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar*” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁶ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “*Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.*” Ndërkohë që në nenin 5 parashikohet: “*Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë*

⁴ Dëshmia e Invaliditetit ka afat vlefshmërie deri në 03.11.2020.

⁵ Referuar nenit 1, pika 1, të Konventës “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

⁶Ratifikuar me ligjin nr 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

së kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në çdo rrethanë."

Në nenin 17, të Konventës së sipërpërmendur parashikohet shprehimisht mbrojtja e integritetit fizik dhe mendor të personit me aftësi të kufizuar. Në këtë nen parashikohet shprehimisht: *Çdo person me aftësi të kufizuar ka të drejtën e respektit ndaj integritetit të saj/ tij fizik dhe mendor njësoj si pjesa tjetër e popullsisë.*"

Invalidët e punës janë një nga kategoritë e personave me aftësi të kufizuar. Në nenin 1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "*Për Statusin e Invalidëve Të Punës*", (të ndryshuar), parashikohet se: "*Statusin e invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme, që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", i ndryshuar dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*"

Në nenin 2, të ligjit të mësipërm (të ndryshuar) parashikohet detyrimi i shoqërisë dhe shtetit për të marrë në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njësoj si të tjerët. Shteti ka detyrim që invalidëve të punës t'u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t'u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese.

Në nenin 3, të këtij ligji parashikohet gjithashtu se: "*Shteti mbron invalidët nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes.*"

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: "*a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin*".

“Aftësia e kufizuar” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”* Mbështetur në pikën 2, të të njëjtit nen përcaktohet shprehimisht: *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”*

Neni 20 i ligjit të sipërpërmendur parashikon shprehimisht mbrojtjen nga diskriminimi, të individëve, për shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të tij, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

Kodi i Procedurës Administrative⁷, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast operatorit urban “Remi Trans”, i cili duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë*

⁷ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS⁸ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.**

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.⁹

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të ankueses, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka gjykuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankueseve nga ana e Remi Trans sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria Remi Trans nuk i është përgjigjur asnjëherë shkresave të dërguara nga Komisioneri dhe nuk ka dërguar dokumentacionin e kërkuar nga KMD. E vetmja korrespondencë me këtë shoqëri ka qenë e-maili i dërguar nga z. A.P. në adresën zyrtare të KMD-së ku njofton se z. XH.D. është larguar nga puna. Referuar aktit “*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna*” nr. 153, datë 14.02.2020, rezulton se z. Xh.D. shofer autobusi është larguar nga detyra, në këtë datë.

Për sa më sipër, Komisioneri sqaron se qëllimi i hetimit administrativ të ankesës së znj. S.K. nuk ka qenë asnjëherë largimi nga puna i shoferit apo faturinos së autobusit me targë AA 397 TM, të

⁸ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

⁹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

shoqërisë “Remi Trans” sh.p.k. dhe masa e marrë ndaj tij konsiderohet jo e përshtatshme dhe e pakërkuar nga KMD.

Shoqëria “Remi Trans” sh.p.k. duhet të dërgonte informacionin e kërkuar nga KMD, në shkresat e drejtuara ndaj këtij operatori urban, por jo të largonte nga puna shoferin e autobusit, për të shmangur përgjegjësinë e saj, ndaj veprimit të kryer nga faturino i këtij autobusi, ndaj znj. S.K. Këtij operatori urban iu kërkua në mënyrë të përsëritur, që Dëshmia e Invaliditetit t’i kthehej mbrapsht ankueses dhe ky operator as nuk i ka vepruar dhe as nuk i ka kthyer përgjigje Komisionerit.

Komisioneri gjykon se në asnjë rast ky operator urban nuk ka vërtetuar asnjë prej momenteve të sipërpërmendura, së pari se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ndaj të cilit ankuesja u ekspozua dhe së dyti se megjithëse trajtimi ndaj ankueses është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekzistonte një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv. Komisioneri gjykon se qendrimi ndaj së cilit ankuesja u ekspozua në datën 12.12.2020, nga ana e faturinos së autobuzit të operatorit Remi Trans konsiderohet jo vetëm i padrejtë dhe disfavorizues, por fyes e denigrues ndaj saj, për shkak se ajo ishte me aftësi të kufizuar.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se ankuesja S. K. është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Remi Trans sh.p.k.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të znj. S.K., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Remi Trans sh.p.k.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Administratori i kësaj shoqërie t’i kërkojë falje ankueses, për mungesën e respektit të treguar nga ana e punonjësit të tij.

3. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Shoqëria “Remi Trans” sh.p.k. t’i kthejë znj. S.K., Dëshminë e Invaliditetit, që ankueses i është sekuestruar padrejtësisht nga faturino i autobusit me targë AA 397 TM.
4. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, shoqëria “Remi Trans” sh.p.k. të marrë masa për mospërsëritjen e situatave të tilla kundrejt personave me aftësi të kufizuar.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni për këtë vendim, Shoqëria “Remi Trans” sh.p.k. të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Shkak – aftësi e kufizuar
Fusha – Shërbime
Lloji i Vendimit - Diskriminim